

VENDIM
Nr. 587, datë 18.10.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI RRUGA ‘APULIA’ (PARALEL ME LINJËN
HEKURUDHORE–PLAZH), BASHKIA DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstrukcioni rruga ‘Apulia’ (paralel me linjën hekurudhore–plazh), Bashkia Durrës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 21 411 719.6 (njëzet e një milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 21 411 719.6 (njëzet e një milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Durrës.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Durrës.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Durrës.

8. Bashkia Durrës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Durrës.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Durrës.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Durrës.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTT:
 “RIKONSTRUKSIONI RRUGA ‘APULIA’ (PARALEL ME LINJËN HEKURUDHORE–PLAZH), BASHKIA Durrës

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)								Vlerësimet për shpronësim sipas llojit të pasurisë			Shënime
												Shpronësim tokë “truall”			
	Emër	Atësi	Mbiemër	ZK	Nr. i pas	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Truall	Ndërtesë	Volum	Faqe	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	
1	Lejla	Teufik	Haznedari	8518	48/14	Truall	1967	1967		17	190	404	19336	7811744	Konfirmuar nga ASHK-ja. Titulli i pronësisë së kësaj pasurie përfshin edhe pasurinë nr. 48/47, vol. 78, f. 98, e cila është kufizuar për mbivendosje me dok. noterial nr. 910/508, datë 1.3.2017, pajset me certifikatë pronësie për pjesën e lirë me sip. 1967, me ref. 31065.
	Violeta	Teufik	Manushi												
	Hasan	Teufik	Kalatsi												
	Klebeta	Sabri	Kalatsi												
	Denada	Sabri	Negollari												
2	Arianita	Gezim	Hasa	8518	48/20	Truall	3870	3870		45	155	214	19336	4137904	Konfirmuar nga ASHK-ja D- Mbi këtë truall ngrihet ndërtesa nr. 48/9/nd., vol. 127, f. 188.
	Bujare		Hasa												
	Fatmir		Hasa												
	Kujtim		Hasa												
	Mynyre		Hasa												
	Neta		Hasa												
	Teuta		Starova												
Tomorr		Hasa													
3	Drita		Paja	8518	48/51	Truall	300	300		78	90	6.1	19336	117949.6	Konfirmuar nga ASHK-ja E-00080 datë regj. 10.10.2012. Kufizohen veprimet deri në plotësimin e dok. tekniko-ligjor.
4	Kimete		Gjoka	8518	48/19	Truall	1065	1065		44	229	415	19336	8024440	Konfirmuar nga ASHK= -ja D- Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa vol. 132, f. 154.
	Dhurata		Magjistari												
	Silvana		Leka												
	Maksim		Haxhiu												
	Merushe		Haxhiu												
	Fellenza		Koçi												
	Lumturi		Xhabija												
	Xheni		Agovi												
	Miguel		Magjistari												
	Elin		Magjistari												
	Martin		Magjistari												
David		Leka													
5	Kimete		Gjoka	8518	48/13	Truall	1200	1200		12	137	57	19336	1102152	Konfirmuar nga ASHK-ja. D- mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. 48/92/nd., vol. 121, f. 197, në pronësi të Tahir Sharka me leje
	Dhurata		Magjistari												
	Martin		Magjistari												
	Elin		Magjistari												

	Silvana		Leka												legalizimi.
	David		Leka												
	Maksim		Haxhiu												
	Merushe		Haxhiu												
	Fellenza		Koçi												
	Lumturi		Xhabija												
	Xheni		Agovi												
miguel		Magjistari													
6	Erton	Fuat	Çafaj	8518	43/225	Truall	345	345		136	43	11.25	19336	217530	Konfirmuar nga ASHK-ja D- U krye RVP datë 21.2.2020, për vlerën 6.670.920 lekë.
	Emirjona	Nuri	Selimi												
Vlera totale														21,411,719.60	